

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE ILIRJANA I TABAKU

Nr 882 Rep.
Nr 349/ Kol.



Adresa: Tirane, Rr. Durrës, Blloku Gintash, Godina 10/a

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot, më datë 17.04.2014 (dymijë e katërmbedhjetë), para meje noteres publike Ilirjana Tabaku, Notere e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në Rr. Durrës, Blloku Gintash, Godina 10/a, u paraqitën palët e mëposhtme:

SHITESI : Z. LULZIM KAPLLANAJ, atesia Isuf, lindur me 15.11.1984 ne Fratar/ Fier, banues ne Durrës, Lagja 14, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me dokument identifikimi leternjoftim 030037956, me nr. Personal I41115138A, shtetas shqiptar, ne cilesine e aksionerit te shoqerise **"LEXALKO"SH.A**, zoterues i 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

BLERESI: Z. LUAN KAPLLANAJ, atesia Isuf, lindur me 08.11.1975 ne Fratar/Fier, banues ne Durrës, Lagja 14, banese private, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me dokument identifikimi leternjoftim 028015416, me nr. personal H51108158H, shtetas shqiptar, ne cilesine e aksionerit te shoqerise **"LEXALKO"SH.A**, zoterues i 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Duke qenë se ekzistojnë keto kushte paraprake:

Shitesi, **Z. LULZIM KAPLLANAJ**, është pronar me të drejta të plota i masës prej 50% të kuotave te kapitalit të shoqërisë **"LEXALKO"SH.A**, me seli ne Tiranë, Kthesa e Kamzës, ndertese 3 kateshe, regjistruar si person juridik me date 22.10.2010, pajisur me **NIPT L02222010A**, me dy aksionere, me kapital prej 5.000.000 (pesemilion) leke, te ndare ne 5000 kuota, me vlerë nominale të një kuote prej 1000 (nje mije) Leke, me objekt: Import-Export, shitje me shumice e pakice, te makinerive te renda, mjeteve te transportit etj....., SHITESI ka vendosur të tërhiqet nga shoqëria nëpërmjet SHITJES SE AKSIONEVE. Kuotat i janë ofruar per shitje BLERESIT, aktualisht aksioner i shoqërisë, zoterues i 50% te aksioneve, i cili ka pranuar blerjen. Aksioneret e shoqerise, sipas vendimit nr.8, date 15.04.2014 te mbledhjes se asamblese se pergjithshme kane dhënë dhe pranuar miratimin për këtë shitje. *Palët bien dakord për hartimin e kësaj kontrate shitje si më poshtë:*

NENI 1-OBJEKTI

Shitesi i shet bleresit 50% të kuotave që zotëron në kapitalin e shoqërisë **"LEXALKO"SH.A**, në gjendjen e faktit dhe të te drejtave në të cilën ndodhen, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi kuotat.

NENI 2-GARANCITË

Shitesi deklaron dhe garanton se është pronar i vërtetë dhe i vetëm i masës prej 50% të kuotave në kapitalin e Shoqërisë **"LEXALKO"SH.A**

Shitesi deklaron gjithashtu se kuotat e kapitalit janë nënshkruar dhe shlyer prej tij në tërësinë e tyre dhe se kuotat e kapitalit janë të lira nga cdo barrë apo pretendim i të tretëve.

NENI 4-KALIMI I PRONËSISË

Me regjistrimin e kësaj kontrate në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, shitesi do të humbasë të drejtat e tij mbi pronësinë e 50% të kuotave në Shoqërinë **"LEXALKO"SH.A**, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi to. Gjithashtu shitesi do të humbasë cilësinë e aksionerit të shoqërisë **"LEXALKO"SH.A**. Nga ana tjetër, me regjistrimin e kësaj kontrate në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të

Regjistrimit, bleresi do të bëhet aksioner i vetem i shoqërisë duke zotëruar 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi to. Kapitali themeltar i Shoqërisë, "LEXALKO"SH.A, pas realizimit dhe regjistrimit të kësaj kontrate shitje të zotërohet si më poshtë vijon:

- **LUAN KAPLLANAJ**, në cilësinë e aksionerit të vetem të shoqërisë do të zotërojë masën prej 100% të kapitalit të barabartë me 5000 kuota, me vlerë nominale secila prej 1000 lek dhe vlerë të përgjithshme prej 5.000.000 leke.

NENI 5- SHPENZIMET E KONTRATËS

Shpenzimet noteriale dhe të hartimit të kësaj kontrate janë në ngarkim të dy palëve në këtë kontratë.

NENI 6-LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Çdo aspekt që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë kontratë do të disiplinohet nga dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë që i referohen kontratave të shitjes dhe legjislacionit tregtar në fuqi.

NENI 7-ZGJIDHJA E MOSMARRËVSHJEVE

Në rast mosmarrëveshjeje rreth zbatimit dhe interpretimit të kësaj kontrate, palët bien dakord ta zgjidhin atë në rrugë miqësore. Në rast se kjo nuk është e mundur, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është Gjykata.

NENI 8-DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo kontratë është redaktuar në 4 kopje, në gjuhën shqipe dhe pasi iu lexua palëve qarte e me ze të lartë nga një noteri, u konsiderua e redaktuar sipas pelqimit të tyre dhe u nënshkrua me vullnet të lirë e të plotë para meje noteres.

Kjo kontratë u hartua në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe, me tre faqe, dhe, pasi iu lexua palëve qarte nga një noteri dhe u gjet në përputhje me vullnetin e plotë dhe të lirë të tyre, u nënshkrua prej palëve të kësaj kontrate pa asnjë vërejtje përpara meje Noterit. Une Noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.

BLERESI

SHITESI

Luan Kapllanaj


Lulzim Kapllanaj


NOTERE
ILIRJANA ITABAKU



"LEXALKO" SH.A,
NIPT L02222010A
Tirane
Kthesa e Kamzes , ndertese 3 kateshe,

VENDIM NR. 8, DATE 15.04.2014

I ASAMBLESE SE PERGJITHSME TE AKSIONEREVE TE SHOQERISE
"LEXALKO"SH.A,

Sot, më datë 15.04.2014 , ne seline e shoqerise ne Tirane, Kthesa e Kamzes , ndertese 3 kateshe, u zhvillua mbledhja e asamblese se pergjithshme te aksionereve shoqerise **"LEXALKO" SHA,** regjistruar si person juridik me date 22.10.2010, pajisur me **NIPT L02222010A,** për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës, si më poshtë vijon:

1. Shitja e 50% të kuotave te zoteruara në kapitalin e shoqerise , nga aksioneri Z. Lulzim Kapllanaj dhe blerjen e tyre nga aksioneri tjetër Z. Luan Kapllanaj.
2. Emerimin e Z. Luan Kapllanaj, si administrator i shoqerise, per nje afat 3 vjecar.
3. Autorizimin e Z. Ismail Maloku, te kryeje te gjithë procedurat e nevojshme per regjistrimin e vendimit dhe te kontrates se shitjes prane QKR-se.

Pas realizimit të aktit të shitjes te kuotave Z. Lulzim Kapllanaj , humbet pronësinë mbi kuotat e zoteruara te kapitalit dhe si rrjedhim humbet cilesine e aksionerit ne shoqeri dhe ne kete menyre kapitali i shoqërisë do të zotërohet ne masen 100 % te kuotave nga Z. Luan Kapllanaj, duke u bere ky i fundit aksioner i vetem i shoqerise **"LEXALKO" SHA.**

Ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme moren pjese te dy aksioneret e shoqerise Z. Lulzim Kapllanaj dhe Z. Luan Kapllanaj, qe te dy se bashku zoterojne 100 % te aksioneve, duke e bere te vlefshme mbledhjen.

Mbledhja e asamblese se pergjithshme , në mbështetje me Statutin e Shoqërisë dhe ligjin Për Shoqëritë Tregtare, duke mos patur pikë tjetër për të diskutuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e shitjes se 50% të kuotave te zoteruara në kapitalin e shoqerise , nga aksioneri Z. Lulzim Kapllanaj dhe blerjen e tyre nga aksioneri tjetër Z. Luan Kapllanaj.
2. Emerimin e Z. Luan Kapllanaj, si administrator i shoqerise, per nje afat 3 vjecar.
3. Autorizimin e Z. Ismail Maloku, te kryeje te gjithë procedurat e nevojshme per regjistrimin e vendimit dhe te kontrates se shitjes prane QKR-se.

AKSIONARET E SHOQERISE
LEXALKO SH.A

Luan Kapllanaj
[Signature]

Lulzim Kapllanaj
[Signature]

LEXALKO SH.A
Rruga Dritan Hoxha, Nd 217 H.2
Kodi Postar 1023 Tirane - Albania
Tel 00355 42414022 Fax 00355 42414023
NIPT . L02222010A